



REPUBLIKA E SHqipëRISE  
MINISTRIA E FINANCAVE

Prill 2017

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Maj

Qershor

Korrik

Gusht

Shtator

Tetor

Nëntor

Dhjetor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prill 2017

© Ministria e Financave, 2017

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [eva.doda@financa.gov.al](mailto:eva.doda@financa.gov.al)  
[vivi.besho@financa.gov.al](mailto:vivi.besho@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Bilancit Fiskal	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin prill 2017 arriti në 104.02 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin prill 2017 ishte 1.9 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin prill 2017 ishte 126.33 lekë për dollarë dhe 135.42 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit prill 2017 shënuan kuotën 0.81 për qind për ato 12 –mujore; 0.53 për qind për depozitat 6-mujore; 0.25 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.97 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 3.89 për qind për huatë 12-mujore dhe 6.55 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,246,173 milionë lekë në muajin prill, duke shënuar një rritje prej rreth 3.8 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e parë të 2017-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 8.6 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-prill 2017 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 10.4 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 9.0 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 1.4 milione lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-prill 2017, arritën në rreth 140.2 miliardë lekë ose afërsisht 105 për qind e planit për këtë periudhë.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 129.8 miliardë lekë ose 99 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.


# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin prill 2017 ishte 1.9%. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 0.3 %.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin prill 2017 shënoi rënie prej 0.6 për qind krahasuar me muajin paraardhës. Ky indeks ka shënuar rritje edhe për muajt mars e shkurt 2017 me përkatësisht 0.4 dhe 0.5 për qind në krahasim me muajt paraardhës përkatës. Përsa l përket një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin prill 2016 shënoi gjithashtu rënie prej 0.4 për qind në krahasim me muajin paraardhës. Ndërsa në muajt shkurt dhe mars 2016, indeksi i çmimeve të konsumit

shënoi respektivisht rritje me 1.1 për qind dhe 1.5 për qind krahasuar me muajt paraardhës përkatës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +3,0%, duke kontribuar me +1,25 pikë përqindje; “Transporti” me një rritje vjetore të çmimit prej +4,3%, duke kontribuar me +0,25 pikë përqindje; “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me një rritje vjetore të çmimit prej +0,9%, duke kontribuar me +0,18 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1,9%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm e shënoi kategoria “Veshje dhe këpucë ” me një rënie

vjetore të çmimit prej -2,3%, duke ndikuar negativisht me -0,09 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +1,9%.

Ndryshimi mujor i indeksit është **-0,6%**. Krahasuar me muajin mars 2017 ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Veshje dhe këpucë” me 1,7%, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 1,4%, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,3%. Rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Argëtim dhe kulturë” me 1,3%, pasuar nga grupet “Transporti” me 0,5%, “Komunikimi” me 0,3%, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,2 %.

**Tab - 1** *Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)*

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2016	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2	1.9	2.0	1.8	1.5	1.9	2.2
2017	2.8	2.2	2.1	1.9								


Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin prill 2017, arriti në 135.42 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.03 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit prill, një euro u këmbye me 135.03 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin prill 2017 arriti në 126.33 lekë/dollarë duke shënuar rënie me 0.33 për qind kundrejt muajit mars 2017. Në fund të muajit prill, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 123.55 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin prill të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj monedhës evropiane në masën 2.23 për qind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është mbiçmuar në masën 3.37 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës evropiane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.93 dollarë/euro. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave


Gjatë muajit prill 2017, normat e interesit të depozitave me afat 12-mujor shënuan nivelin prej 0.81 për qind, pasuar nga ato me afat 6-mujore që arritën kuotën 0.53 për qind. Normat e interesit të depozitave me afat 3 dhe 1-mujore shënuan përkatësisht kuotat 0.25 dhe 0.97 për qind. Normat e interesit të depozitave 12, 6 dhe 3-mujore në lekë kanë shënuar rënie në krahasim me muajin e mëparshëm, ku rënia më e madhe 0.12 pikë përqindje vihet re tek normat e interesit me afat maturimi 12-mujor. Ndërsa normat e interesit të depozitave 1 mujore kanë mbajtur të njëjtin nivel prej 0.97 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë shënuar normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6 dhe 3-mujore me përkatësisht 0.12 ; 0.2 dhe 0.08 pikë përqindje. Rritje vjetore kanë shënuar vetëm normat e interesit me afat 1-mujor me 0.25 për qind.

Interesi i huave 6 dhe 12 mujore gjatë muajit prill 2017 arritën përkatësisht kuotën prej 6.55 dhe 3.89 për qind duke shënuar rënie mujore prej përkatësisht 1.89 dhe 2.82 për qind. Norma e interesit të huave 6 dhe 12-mujore shënuan gjithashtu rënie vjetore prej 3.12 dhe 0.40 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit prill 2017, për bonot 6 dhe 12-mujore ishin përkatësisht 1.52 dhe 1.79 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rënie mujore e këtyre *yield*-ve të bonove të thesarit dhe rënien më të madhe e kanë shënuar ato 12-mujore me 0.46 për qind.


Fig. 3



**Normat e interesit për depozitat (%)**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



**Normat e interesit për huatë dhe bonot**



Burimi: Banka e Shqipërisë

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e katërt të vitit 2016 shënoi rritje të mjetëve valutore, me rreth 8.6 milionë euro. Tremujori i parë i 2017-ës u mbyll me një defiçit të llogarisë korrente prej rreth 179 milionë euro, në tkurrje referuar të njëjtës periudhë të një vit më parë, me rreth 20%. Defiçiti tregtar u ngushtua me rreth 22%, në nivelin 313 milionë euro, dhe përbën faktorin kryesor në përmirësimin e defiçitit korrent. Flukset e kapitalit, shuma e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 238.9 milionë euro. Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Gjatë periudhës, transaksionet në llogarinë korrente vlerësohen rreth 2,204 milionë euro dhe janë zgjeruar me 13% në terma vjetorë. Defiçiti i llogarisë korrente shënon 179 milionë euro, rreth 20% më i ulët krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i defiçitit korrent i atribuohet edhe zgjerimit në sufiçitin e llogarisë së shërbimeve si “shërbime transporti” apo “shërbime të tjera biznesi”. Kompozicioni deficitit të llogarisë korrente shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për tremujorin e parë 2017 (Fig-6):


- (i) bilanci tregtar me -587.1 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 273.8 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me -35.8 milionë euro,
- (iv) transferta neto me 169.8 milionë euro.



## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit prill 2017, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 125,496 milionë lekë krahasuar me muajin prill të vitit 2016. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 92,421 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë të me rreth 33,075 milionë lekë.

Fig-7




**Ecuria e M.V.N. të sistemit në Prill '16 - Prill '17**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,246,173 milionë lekë në muajin prill 2017, duke shënuar rritje prej rreth 45,955 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 3.8 për qind. Në muajin prill 2017, sistemi bankar rezulton me një rritje prej 3,176 milionë lekë ose 3.2 për qind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.

Fig-8



**Agregati M3 Prill '16 - Prill '17**

Burimi: Banka e Shqipërisë


## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin prill 2017 arriti në rreth 545,306 milionë lekë. Balanci e kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rënie me vlerë 2,226 milionë lekë, pra rënie prej rreth 0.4 për qind. Struktura e kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 52 për qind të totalit të tepriçës së kredisë me rreth 283,726 milionë lekë.

Gjatë muajit prill 2017, zëri “Korporata jo-financiare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 62.0 për qind ose 338,225 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 31.14 për qind ose 169,790 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.05 dhe 1.64 për qind apo 27,543 dhe 8,932 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin prill 2017, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 50.34 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 38.69 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 72.80 për qind dhe rreth 24.17 për qind.


Fig-9



**Rritja e stokut total të kredive**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10




**Përberja e kredive Prill '17**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 246,446 milionë lekë në fund të muajit prill 2017. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në prill 2017 ka shënuar rritje mujore prej 0.10 për qind si dhe rritje vjetore prej 1.07 për qind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar gjithashtu rritje mujore prej 0.16 për qind dhe rritje vjetore prej 1.6 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin prill 2017, kanë pësuar rënie prej 6,642 milionë lekë në krahasim me muajin prill 2016. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 85.1 për qind të tyre. Ndërsa depozitat në valutë gjatë muajit prill 2017 shënuan rritje prej 30,632 milionë lekë, mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 82.1 për qind të depozitave në valutë.

Fig-12




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit prill 2017, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 85.1 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 10.3 për qind dhe nga “Korporata të tjera financiare” me 2.3 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 82.1 për qind dhe rreth 16.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 83.5 për qind e totalit.

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 835,090 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (133,127 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (17,021 milionë lekë) dhe “Korporata jofinanciare publike” (12,372 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 2,117 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit prill 2017, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën 999,727 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej rreth 981 milionë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 23,991 milionë lekë.

Fig-14



**Përberja e depozitave Prill 2017**

Burimi: Banka e Shqipërisë


# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-prill 2017 janë mbledhur rreth 140.2 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 129.8 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 114.2 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 15.2 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 72% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 93.3 miliardë lekë (ose rreth 106% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushtetit vendor rreth 7.8 miliardë lekë (ose rreth 119% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 28.1 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 8.5 miliardë lekë (ose rreth 102% e planit të periudhës janar-prill 2017).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 114.2 miliardë lekë, 22.6 miliardë lekë (20% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 9.7 miliardë lekë (9%) për interesat, 11.1 miliardë lekë (10%) për



shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 340 milionë lekë (0.3%) për subvencione, 47.4 miliardë lekë (41.5%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 13.2 miliardë lekë (11.6%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 6.9 miliardë lekë (6.1%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 30% (shpenzime personeli), 23% (shpenzime për interesat), 25% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 15% (subvencione), 30% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 32% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 30% (shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 23%, ndërsa financimi i huaj është 13% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-prill 2017 ishin rreth 140.2 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 129.8 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 8.5 miliardë lekë.

Tab - 2

*Të ardhurat gjatë periudhës Janar-Prill 2017 (mld Lekë)*  
*Revenues during January-April 2017 (in billion ALL)*

Burimi (Source)	Prill '17 April '17	Prill '16 April '16	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	41.9	40.4	2.9
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	13.4	12.8	4.9
Taksa doganore (Custom Tax)	1.8	1.7	3.8
Taksat nacionale (National Tax)	11.9	9.9	20.1
Akcizat (Excise)	12.9	11.9	8.0
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	10.3	10.5	-1.7

*Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Qershor – 2017;*

*Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: June – 2017;*

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 10.4 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Prill 2017, u përdor kryesisht për pagesën e maturimit të huamarrjes së brendshme dhe për huanë afatgjatë të huaj.

Për muajin prill 2017, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 38.736 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 34.636 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin prill 2017, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 23.3 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 29.3 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 4.9 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2012	2013	2014	2015	2016	2017	
Janar	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	1.5	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	0.9	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	2.8	January
Shkurt	1.3	1.1	1.4	2.4	1.1	0.5	1.0	1.05	1.1	1.9	1.0	1.0	0.6	2.5	1.9	2.3	0.2	2.2	February
Mars	0.4	0.2	0.5	0.4	0.5	0.4	0.8	0.77	0.9	1.4	0.8	0.8	1.0	2.4	2.2	2.2	0.3	2.1	March
Prill	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	-0.4	<b>-0.6</b>	0.6	0.55	0.5	0.9	0.5	<b>0.7</b>	1.6	2.3	1.7	2.3	0.3	<b>1.9</b>	<b>April</b>
Maj	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	-1.2		0.3	0.24	0.2	0.4	0.2		1.9	2.1	1.6	1.8	0.7		May
Qershor	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.6		0.1	0.15	0.1	0.1	0.04		2.2	2.3	1.5	1.4	1.2		June
Korrik	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7	0.05		0.1	-0.03	0.0	0.2	0.29		2.7	1.6	1.8	1.3	1.9		July
Gusht	0.4	-0.1	0.1	0.8	0.86		0.1	-0.04	0.0	0.1	0.29		2.8	1.2	2.0	1.9	2.0		August
Shtator	0.2	0.8	0.3	0.6	0.40		0.1	0.06	0.0	0.2	0.17		2.6	1.7	1.5	2.2	1.8		September
Tetor	0.2	0.1	0.1	0.01	-0.2		0.1	0.05	0.0	0.2	0.13		2.4	1.7	1.4	2.1	1.5		October
Nëntor	0.2	-0.5	-0.2	-0.3	0.1		0.1	0.01	0.0	0.1	0.12		2.5	1.0	1.7	2.1	1.9		November
Dhjetor	0.9	1.7	0.7	0.6	0.9		0.2	0.15	0.1	0.17	0.19		2.4	1.9	0.7	2.0	2.2		December

Burimi: INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**  
Exchange rate

Monedha	2013	2014	2015	2016	2017				Currency
					Janar	Shkurt	Mars	Prill	
					January	February	March	April	
<i>Mesatarja e periudhës</i>									<i>Average of period</i>
USD	105.67	113.64	126.64	128.29	128.40	127.43	126.74	126.33	USD
EURO	140.27	140.11	137.65	135.27	136.57	135.59	135.38	135.42	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>									<i>In the end of period</i>
USD	101.86	115.23	125.79	128.17	127.37	127.45	127.34	123.55	USD
EURO	140.20	140.14	137.28	135.23	136.39	135.08	136.13	135.03	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2013	2014	2015	2016	2017				
Në përqindje					Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	In percent
<b>Norma e depozitave</b>									Deposits rates
12-M	4.17	1.51	1.27	0.78	0.69	0.94	0.90	0.81	12-M
6-M	3.40	1.16	1.17	0.78	0.57	0.78	0.58	0.53	6-M
3-M	2.72	0.83	0.54	0.27	0.31	0.27	0.28	0.25	3-M
1-M	2.79	1.47	0.88	0.87	0.86	0.68	0.97	0.97	1-M
<b>Norma e huasë</b>									Lending rates
12-M	9.52	7.00	7.47	4.54	6.27	6.87	6.71	3.89	12-M
6-M	9.59	8.18	8.35	7.01	9.74	8.60	8.44	6.55	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>									Securities rates
Bono thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	3.40	3.15	-	-	1.22	-	-	-	3-M
6-M	3.54	3.16	2.46	2.00	2.25	2.01	1.70	1.52	6-M
12-M	3.66	3.33	2.40	2.92	3.20	2.93	2.25	1.79	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2017

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2017

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>32,893</b>	<b>64,046</b>	<b>101,554</b>	<b>140,290</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>186</b>	<b>644</b>	<b>1,415</b>	<b>1,933</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>30,935</b>	<b>59,660</b>	<b>94,551</b>	<b>129,856</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>22,022</b>	<b>42,806</b>	<b>69,995</b>	<b>93,352</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,146	20,237	31,302	41,918	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,620	3,827	11,177	13,447	Profit Tax
3	Akcizat	2,727	5,730	9,242	12,928	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,185	5,414	7,663	10,373	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,930	6,734	9,252	12,845	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	414	864	1,359	1,841	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>907</b>	<b>2,398</b>	<b>3,866</b>	<b>7,869</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	195	410	774	2,133	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	8	31	204	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	710	1,980	3,061	5,532	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>8,006</b>	<b>14,456</b>	<b>20,690</b>	<b>28,635</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	6,743	12,238	17,537	24,221	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,146	1,970	2,780	3,922	Health insurance
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,772</b>	<b>3,742</b>	<b>5,588</b>	<b>8,501</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				908	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,320	2,901	4,108	5,222	Income of budgetary institutions
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>25,636</b>	<b>55,790</b>	<b>95,188</b>	<b>129,824</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>24,640</b>	<b>52,729</b>	<b>84,833</b>	<b>114,223</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>5,476</b>	<b>10,992</b>	<b>16,585</b>	<b>22,606</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	4,700	9,451	14,257	19,446	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	776	1,541	2,328	3,160	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>2,830</b>	<b>5,570</b>	<b>7,823</b>	<b>9,795</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	2,078	4,190	5,909	7,291	Domestic
2	Të Huaja	752	1,380	1,914	2,504	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,567</b>	<b>4,503</b>	<b>8,630</b>	<b>11,105</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveclonet</b>	<b>55</b>	<b>108</b>	<b>242</b>	<b>340</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>11,892</b>	<b>23,845</b>	<b>37,429</b>	<b>50,126</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	8,645	17,397	27,010	36,420	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,640	5,319	8,284	11,063	Health insurance
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>1,789</b>	<b>4,855</b>	<b>8,914</b>	<b>13,269</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,031</b>	<b>2,856</b>	<b>5,210</b>	<b>6,982</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	41	74	108	140	Unemployment insurance benefits
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>		0		0	<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,254</b>	<b>3,127</b>	<b>10,300</b>	<b>15,224</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	118	1,246	7,086	10,898	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,136	1,881	3,214	4,326	Foreign financed
IV	<b>Detyrimet e papambetuara</b>		0		0	<b>Arrears</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>7,257</b>	<b>8,256</b>	<b>6,366</b>	<b>10,466</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-7,257</b>	<b>-8,256</b>	<b>-6,366</b>	<b>-10,466</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-7,785</b>	<b>-18,552</b>	<b>-15,516</b>	<b>-15,343</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	4	24	123	283	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	7,474	8,681	11,187	11,815	Domestic new borrowing (net)
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-105	-112	-109	-114	Other-Float
V.3	<b>I huaj</b>	<b>528</b>	<b>10,296</b>	<b>9,150</b>	<b>4,877</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,473	2,185	2,924	5,667	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nën-hua	391	768	1,128	1,937	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-312	-144	41	-1,298	Chang. of stat. Account
4	Ripagesat	-811	-1,793	-3,863	-9,540	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	178	10,048	10,048	10,048	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\* "Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

\* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2017**

Table of investments 2017

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>118</b>	<b>1,246</b>	<b>7,086</b>	<b>10,898</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	9.41	39.85	68.80	71.58	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>1,136</b>	<b>1,881</b>	<b>3,214</b>	<b>4,326</b>	<b>Foreign financing</b>
Në %	90.59	60.15	31.20	28.42	In %
<b>Totali</b>	<b>1,254</b>	<b>3,127</b>	<b>10,300</b>	<b>15,224</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2017**

Table of investments 2017

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>118</b>	<b>1,246</b>	<b>7,086</b>	<b>10,898</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	9.41	39.85	68.80	71.58	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>1,136</b>	<b>1,881</b>	<b>3,214</b>	<b>4,326</b>	<b>Foreign financing</b>
Në %	90.59	60.15	31.20	28.42	In %
<b>Totali</b>	<b>1,254</b>	<b>3,127</b>	<b>10,300</b>	<b>15,224</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2017  
CUSTOMS REVENUES 2017**

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million Lek)*

	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	
Taksë doganore	414	864	1,359	1,841	Customs Duties
TVSH	5,775	13,085	22,069	30,209	V.A.T
Akcizë	2,727	5,730	9,242	12,928	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	250	438	585	937	Others (Mineral Rent)
<b>TOTALI</b>	<b>9,166</b>	<b>20,117</b>	<b>33,255</b>	<b>45,915</b>	<b>Total</b>

**TË ARDHURAT TATIMORE 2017 (TAX REVENUE )**

TVSH	4,370	7,151	9,233	11,709	V.A.T
Tatim mbi fitimin	1,620	3,827	11,177	13,447	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	3,185	5,414	7,663	10,373	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	3,680	6,296	8,667	11,908	National taxes
